


JETOJMË NË HARMONI

JEMI TË BARABARTË

OLTI (10), LORENTI (11), GRANIT (10), SUHEJB (10), MERJEME (10), ARISA (11), RINESA (10),

ERION G. (10), ERZA (11)



Vendimmarrja është e popullit. Demokracia na jep shumë të drejta

Ne sot kemi ardhur në Punëtorinë e Demokracisë, ku patëm mundësi të kemi rolin e gazetarëve të Kuvendit. Në grupin tonë kemi diskutuar për të drejtat tona, për lirinë, tolerancën dhe ndikimin e popullit në një vend demokratik.

Fjala demokraci rrjedh nga greqishtja e vjetër që „demo“ do të thotë popull, kurse „kratia“ do të thotë udhëheqje. Pra, demokracia është udhëheqje e popullit. Kjo nënkupton se fuqia qëndron tek populli.

Dallojmë dy forma të demokracisë, ato janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese i ka dy sisteme. Njëri nga ata është sistemi parlamentar, ku populli zgjedh deputetët. Ndërkaq, sistemi tjetër është sistemi presidencial, ku populli zgjedh Presidentin e vendit.

Forma e parë e demokracisë është shfaqur në Athinë, kryeqytetin e Greqisë, në vitin 507 para erës sonë. Në atë kohë, të drejtën e vendimmarrjes e kishin vetëm

burrat e pasur. Gratë dhe skllëvërit nuk e kishin këtë të drejtë. Ndërsa tani, në kohën e sotme të gjithë njerëzit pa dallim të racës, të gjinisë apo të fesë kanë të drejtën e votës.

Ne jemi nxënës të klasës së V-të nga „Shkolla e Gjelbër“ dhe aty shkojmë për të mësuar shumë gjëra. Këtë na mundëson pikërisht demokracia, për shkak se të gjithë e kemi të drejtën e shkollimit. Po të mos e kishim këtë të drejtë, atëherë nuk do të dinim shkrim, lexim dhe vendi ynë nuk do të zhvillohej.

Po ashtu, ne mësuam se përveç kësaj të drejte kemi edhe shumë të drejta të tjera, si: e drejta e lojës, e drejta e familjes, e drejta e strehimit, e drejta e shprehjes së mendimit, e drejta e emrit, etj.

Nëse jemi të bashkuar dhe mendojmë e punojmë për të mirën e vendit, shteti ynë do të përparojë shumë dhe ne do të kemi një jetë më të mirë. Pra, të gjithë ne duhet të jemi të bashkuar.




Ne jemi të përgjegjshëm



Grupi „9 yjet“

LIGJI I FËMIJËVE

LEORIS (11), ERTI (10), ERNES (10), URTINA (11), ANISA (11), ARNESA (10), ALBINA (10),
AGONIT (11), LIRIDONA (10)



Ne jemi gazetarët e klasës V-2 nga „Shkolla e Gjelbër“. Më poshtë do t’iu tregojmë se çfarë kemi mësuar për Kushtetutën dhe ligjin. Ju urojmë lexim të këndshëm në vazhdim

Kushtetuta është libri më i rëndësishëm për Kosovën. Në Kushtetutën e Kosovës ka disa nene, ndër to është edhe Neni për të Drejtat e Fëmijëve. Të gjitha të drejtat tona bazohen në Kushtetutë. Për këtë arsye ne duhet gjithmonë ta respektojmë atë. Kushtetuta u miratua për herë të parë më 9 prill të vitit 2008. Pra, ky libër ndryshe quhet ligj mbi ligje. Ndërsa, më poshtë do të vazhdojmë të shkruajmë për ligjet. Ligji është një set rregullash shoqërore dhe në të duhet të bazohen qytetarët. Për çdo ligj, deputetët


vendosin me anë të votës. Në bazë të ligjit, secili nga ne ka të drejtat e veta dhe të gjithë duhet të trajtoheni në mënyrë të barabartë. Këto ligje mund të propozohen nga Qeveria, Presidenti, deputetët dhe më së paku 10.000 qytetarë, me anë të peticionit. Për shembull, ligjin që e respektojmë çdo ditë është ligji i shkollimit, prandaj ligjet janë të rëndësishme për jetën tonë. Ligjet na e bëjnë jetën tonë më të mirë dhe më të lehtë për këtë arsye ne duhet t’i respektojmë ato.



Kushtetuta e Republikës së Kosovës



Ligji na mëson për të mirën tonë




Deputetët duke votuar një projektligj



Grupi për informatat mbi Kushtetutën

FUQIA E KUVENDIT

EDON (11), ARBRESHA (11), JON (10), ZAHIDE (10), ERION (10), VALONA (10), BLERON (11),
ORNELA (10), ELVIRI (10)



Demokracia është shumë e rëndësishme për vendin tonë, sepse të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës janë të lidhura me demokracinë. Por, a e dijmë se cili është njëri nga elementet kryesore të demokracisë? Për më shumë, mund të lexoni në artikullin tonë më poshtë

Demokracia përfshin lirinë, të drejtat e barabarta, të shprehurit lirshëm, etj. Por ne, mendojmë se elementi kryesor janë zgjedhjet e lira. Me anë të zgjedhjeve të lira, ne mund të zgjedhim përfaqësuesit tanë, siç janë deputetët.

Kuvendi i Kosovës është institucion shtetëror, që ka shumë fuqi. Në Kuvend punojnë deputetët, të cilët janë përfaqësuesit e popullit. Ata merren me problemet e qytetarëve dhe janë aty për të mirën publike. Kuvendi ka shumë fuqi, sepse deputetët kanë për detyrë t'i miratojnë apo shfuqizojnë ligjet.

Përveç miratimit të ligjeve, detyrat e tjera të Kuvendit

të Kosovës janë edhe zgjedhja e Presidentit dhe zgjedhja e Qeverisë. Në Kuvendin e Republikës së Kosovës punojnë 120 deputetë. Nga ta, 100 janë të kombit shqiptar, kurse 20 të tjerë janë nga komunitetet jo shumicë.

Kur është fjala për miratimin e ligjeve, përgjegjësia bie mbi këta 120 deputetë. Ata duhen të jenë shumë të përgjegjshëm në vendimet që i marrin, sepse tërë populli i Kosovës mbështetet tek ta.

Ligjet të cilat i miraton Kuvendi, duhet të respektohen nga të gjithë, sepse nëse ato ligje nuk respektohen atëherë mund të ketë edhe ndëshkime.

Shtetet më të fuqishme në botë janë shtetet demokratike. Ne, gjeneratat e reja do të mundohemi që në të ardhmen ta zhvillojmë edhe më shumë demokracinë, në mënyrë që të renditemi në mesin e shteteve demokratike më të fuqishme të botës.

Shumë faleminderit që e lexuat artikullin tonë.



Seanca gjyqësore



Autorët e artikullit

E DREJTA PËR TË ZGJEDHUR

LORIKU (10), LENDIM (11), ARTINA (10), SARA (10), FISNIKU (10), VESA (11), DRILONI (11),
ERJONA (11), LEONA (11), ERBLINI (11)


Ne kemi të drejtë të zgjedhim për gjërat që neve na pëlqen t'i bëjmë, sepse ne jetojmë në një vend demokratik siç është Kosova

Ne në jetën e përditshme bëjmë zgjedhje të ndryshme, sepse jetojmë në një shtet demokratik. Demokracia është formë e qeverisjes e cila na lehtëson jetën neve qytetarëve, duke na dhënë liri dhe plot të drejta. Ne si nxënës të shkëlqyeshëm që jemi, bashkë me mësuesin tonë kemi vendosur që të gjithë së bashku të shkojmë në një shëtitje në njërin prej vendeve të Kosovës. Ai na ka ofruar tre alternativa, prej të cilave ne nxënësit do të zgjedhim se ku të shkojmë: në Shpellën e Gadimes, tek Lidhja e Prizrenit apo në Muzeun Kombëtar të Kosovës. Ne votuam dhe shumica prej nesh zgjodhëm Lidhjen e Prizrenit, meqë ne si klasë nuk e kemi vizituar asnjëherë këtë vend. Përveç zgjedhjeve të ndryshme që ne bëjmë në jetën e përditshme,

goftë në familje apo edhe në shkollë, ne kemi edhe zgjedhje shtetërore, të cilat janë më të rëndësishme se zgjedhjet e përditshme. Këto janë zgjedhjet lokale dhe ato qendrore. Zgjedhjet lokale organizohen në atë mënyrë që qytetarët e një komune dalin në zgjedhje dhe votojnë për kryetarin e komunës së tyre. Kryetari i komunës ka përgjegjësi të merret me problemet e komunës dhe përpiqet t'i zgjidh ato. Kurse, zgjedhjet qendrore përfshijnë të gjithë qytetarët e Kosovës. Me ç'rast ata votojnë për personat, të cilët kanë kandiduar për deputetë. E shihni të dashur lexues, se sa peshon dhe se sa e rëndësishme është vota jonë? Prandaj, ju rekomandojmë që të mendoni mirë para se të vendosni se kujt do t'ia jepni votën tuaj.



Disa zgjedhje që bëjmë në jetën e përditshme



Ne kemi të drejtë të zgjedhim se çfarë lojërash të luajmë



Ne kemi të drejtë të votojmë



Puna e grupit të gazetarëve të demokracisë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Shkolla e Gjelbër“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë